

VENDIM
Nr.208, datë 16.4.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.

Lista përbëhet nga 140 (njëqind e dyzet) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano